



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. Prot.

Tiranë, më __. __. 2019

**RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
“PËR KATEGORITË E SHËRBIMEVE, TË OFRUARA NGA ENTET
SHTETËRORE DHE SUBJEKTE TË TJERA, TË CILAT PËRFITOHEN ME
ÇMIME TË REDUKTUARA PËRMES PËRDORIMIT TË KARTËS SË
STUDENTIT”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen më çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, ka për qëllim ofrimin e disa kategorive të shërbimit me kosto të reduktuar ose tarifë zero, të cilat do të ofrohen nga entet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjekte të tjera publike dhe private për studentët.

Projektvendimi ka për qëllim përcaktimin e shërbimeve në fushën e artit dhe kulturës, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit, turizmit dhe mjedisit, ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit dhe ato të mbrojtjes, të cilat do të përfitohen nga studentët me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit, si një dokument unik. Në lidhje me përfitimet, shërbimet që do të ofrohen nga entet shtetërore në nivel qendror dhe vendore si dhe subjektet e tjera publike apo private, si dhe vetë IAL-të, krijojnë mundësinë studentëve që të kenë avantazhe të ndryshme financiare, në veprimtari të ndryshme, me anë të përdorimit të Kartës së Studentit, si dokument unik për të gjitha llojet e shërbimeve.

Qëllim tjetër i projektvendimit parashikohet të jetë lehtësimi i përfitimit të shërbimeve më çmime të reduktuara dhe në vendet e Bashkimit Evropian. Karta e

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara, përmes përdorimit të kartës së studentit”

studentit mund të bëhet pjesë e projekteve ndërkombëtare, përmes marrëveshjeve që lidhen nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe organizatat ndërkombëtare që administrojnë projektet ndërkombëtare.

Ky projektvendim ka për qëllim plotësimin e bazës ligjore për ofrimin e shërbimeve për studentët nëpërmjet Kartës së Studentit, si dokument unik për përfitimin e shërbimeve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe me programin analitik të akteve të vitit 2019, miratuar me Vendimin nr. 764, datë 27.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen më çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, është një nga prioritetet e qeverisë për të ofruar lehtësimin kushteve të jetesës dhe studimit për studentët.

Përparësitë që do të sjellë ky projektvendim janë përfitimi i shërbimeve me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit si një dokument unik. Këto përfitime do jenë në fushën e artit dhe kulturës, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit, turizmit dhe mjedisit, ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit dhe ato të mbrojtjes.

Shërbimet që do të ofrohen nga entet shtetërore në nivel qendror dhe vendore si dhe subjektet e tjera publike apo private, si dhe vetë IAL-të, krijojnë mundësinë studentëve që të kenë avantazhe të ndryshme financiare, në veprimtari të ndryshme, me anë të përdorimit të Kartës së Studentit, si dokument unik për të gjitha llojet e shërbimeve.

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara, përmes përdorimit të kartës së studentit”

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore, të cilat përfitohen përmes përdorimit të kartës së studentit”, mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në pikën 4, të nenit 100 të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk lidhet me çështjet e përafrimit të legjislacionit me acquis communautaire.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore, të cilat përfitohen përmes përdorimit të kartës së studentit”, ka për qëllim ofrimin e disa kategorive të shërbimit për studentët me kosto të reduktuar ose shërbime falas nga entet publike, subjekte të tjera, që kanë objekt të tyre interesa studentore, si dhe nga persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme, në bazë të marrëveshjeve.

Përfitimi i këtyre shërbimeve do të jetë për studentët të cilët do të jenë mbajtës të kartës së studentit, si dokument unik me anë të cilës ata do të përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.

Ky projektvendim ka për qëllim lehtësimin e jetës së studentëve nëpërmjet ofrimit të këtyre shërbimeve të sipërcituara.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet se shërbimet që ofrohen nga entet shtetërore në fushën e artit dhe kulturës, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit, turizmit dhe mjedisit, ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit dhe ato të mbrojtjes, përfitohen nga studentët me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit, si një dokument unik i çdo studenti.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se ministrat sipas fushës së përgjegjësisë përkatëse, miratojnë me urdhër të përbashkët me ministrinë përgjegjës për arsimin, listën e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuar për studentët. Efektet financiare

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara, përmes përdorimit të kartës së studentit”

nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxheti i ministrive, sipas fushave të përgjegjësive shtetërore.

Ministritë të cilat kanë fushë përgjegjësie fushën e artit dhe kulturës, fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, fushën e arsimit, sportit dhe rinisë, fushën e transportit, fushën e turizmit dhe mjedisit, fushën e ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit dhe fushën e mbrojtjes do të miratojnë me urdhër të përbashkët, me ministrinë përgjegjëse për arsimin, listën e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuar për studentët. Në urdhrin e përbashkët do të përcaktohen çmimet e reduktuara, për shërbimet e reduktuara që do të ofrohen. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve që do të vendosen në urdhrin e përbashkët, do të përballohen nga buxheti i ministrive, sipas fushave të përgjegjësive shtetërore.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se mbajtësit e kartës së studentit përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara edhe nga subjekte të tjera publike apo private, që kanë për objekt të tyre interesa studentore, në bazë të marrëveshjeve përkatëse pa efekte financiare për buxhetin e shtetit, të nënshkruara me ministrinë përgjegjëse për arsimin.

Subjektet të tjera publike ose private, të cilat kanë objekt interesat studentorë, do të nënshkruajnë marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për arsimin, për shërbimet me çmime të reduktuara që do të ofrohen. Këto marrëveshjet që do të nënshkruhen mes palëve të sipërcituara, nuk do të kenë efekte financiare për buxhetin e shtetit.

Në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet se në nivel vendor, marrëveshjet për ofrimin e shërbimeve më çmime të reduktuara për mbajtësit e kartës së studentit nënshkruhen ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në nivel vendor, marrëveshjet për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara që do të ofrohen nëpërmjet kartës së studentit, do të nënshkruhen ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësive të vetëqeverisjes vendore. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në pikën 5 të projektvendimit përcaktohet se njësitë e vetëqeverisjes vendore nënshkruajnë marrëveshje me subjekte të tjera publike dhe private për ofrimin e shërbimeve më çmime të reduktuara për mbajtësit e kartës së studentit.

Subjektet publike dhe private të cilat do të ofrojnë shërbime me çmime të reduktuara për studentët, do të nënshkruajnë marrëveshje me njësitë e vetëqeverisjes vendore për studentët në territorin nën juridiksionin e tyre administrativ. Në këtë marrëveshje do të përcaktohen shërbimet që do të ofrohen me çmim të reduktuar.

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara, përmes përdorimit të kartës së studentit”

Në pikën 6 të projektvendimit përcaktohet se çdo institucion i arsimit të lartë mund të nënshkruaj marrëveshje pa efekte financiare me subjekte publike apo private për ofrimin e shërbimeve të ndryshme në nivel qendror apo vendore, më çmime të reduktuara për mbajtësit e kartës së studentit.

Institucionet e arsimit të lartë, nëpërmjet këtij projektvendimi, kanë të drejtë të nënshkruaj marrëveshje pa efekte financiare me subjekte publike apo private, të cilat ofrojnë shërbime me çmim të reduktuar për studentët. Ofrimi i këtyre shërbimeve do të jenë të ndryshme nga ato në nivel qendror apo vendore.

Në pikën 7 të projektvendimit përcaktohet se marrëveshjet e lidhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e arsimit të lartë marrin miratimin paraprak në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Ministria përgjegjëse për arsimin konfirmon miratimin, brenda 10 ditëve pune nga njoftimi i marrëveshjes. Në rast se konfirmimi nuk paraqitet brenda 10 ditëve pune, miratimi konsiderohet i dhënë.

Ministria përgjegjëse për arsimin, jep miratimin paraprak për marrëveshjet e lidhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e arsimit të lartë me subjekte të tjera publike dhe private për ofrimin e shërbimeve më çmime të reduktuara për studentët.

Ministria përgjegjëse për arsimin, duhet të njoftohet për marrëveshjet e lidhura ndërmjet palëve të sipërcituara. Ministria përgjegjëse për arsimin konfirmon miratimin, brenda 10 ditëve pune nga njoftimi i marrëveshjes. Në rast se konfirmimi nuk paraqitet brenda 10 ditëve pune, miratimi konsiderohet i dhënë.

Në pikën 8 të projektvendimit përcaktohet se mbajtësit e Kartës së Studentit, përfitojnë të gjitha shërbimet e ofruara sipas përcaktimeve të këtij vendimi, nëpërmjet paraqitjes së kartës së studentit si dokument unik. Shërbimet e ofruara sipas përcaktimeve të këtij vendimi bëhen publike nga të gjitha institucionet qendrore dhe vendore, si dhe nga subjektet publike dhe private në faqet e tyre zyrtare, ndërsa ministria përgjegjëse për arsimin publikon të gjitha shërbimet e siguruara me çmime të reduktuara për mbajtësit e kartës së studentit.

Shërbimet e ofruara sipas përcaktimeve të këtij vendimi, do të bëhen publike nga të gjitha institucionet qendrore dhe vendore, ofruese të shërbimeve përkatëse, si dhe nga subjektet private në faqet e tyre zyrtare.

Ministria përgjegjëse për arsimin publikon të gjitha shërbimet e siguruara me çmime të reduktuara për studentët.

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara, përmes përdorimit të kartës së studentit”

Në pikën 9 të projektvendimit përcaktohet se karta e studentit mund të bëhet pjesë e projekteve ndërkombëtare, përmes marrëveshjeve që lidhen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kjo pjesëmarrje mundëson që shërbimet e ofruara nga këto projekte të përfitohen nga të gjithë mbajtësit e kartës së studentit në shtetet anëtare të projektit apo marrëveshjeve ndërkombëtare. Efektet financiare të pjesëmarrjes në projektet ndërkombëtarë, përballohet nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Shërbimet e ofruara për mbajtësit e Kartës të Studentit përfitohen nga të gjithë mbajtësit e kartës së studentit në Republikën e Shqipërisë si dhe lihet mundësia që ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit të lidhë në bazë të vullnetit të saj të nënshkruaj marrëveshje duke e përfshirë kartën e studentit në projektet të tjera ndërkombëtare.

Kjo pjesëmarrje mundëson që shërbimet e ofruara nga këto projekte të përfitohen nga të gjithë mbajtësit e kartës së studentit në shtetet anëtare të projektit apo marrëveshjeve ndërkombëtare. Efektet financiare të pjesëmarrjes në projektet ndërkombëtarë, përballohet nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Në pikën 10 të projektvendimit përcaktohet se ministria përgjegjëse për arsimin miraton me udhëzim formën, procedurat e përgatitjes dhe administrimit të kartës së studentit. Në rast se prodhimi dhe administrimi i kartës së studentit, i delegohet njësisive të vetëqeverisjes vendore, atëherë ministria përgjegjëse për arsimin, nënshkruan një marrëveshje dypalësh me këto njësi mbi delegimin e këtyre përgjegjësisive dhe kompetencave.

Ministria përgjegjëse për arsimin, do të hartojë udhëzimin për procedurat për përgatitjen, lëshimin dhe funksionimin e kartës së studentit. Në rast se prodhimi dhe administrimi i kartës së studentit i delegohet njësisive të vetëqeverisjes vendore, atëherë ministria përgjegjëse për arsimin, nënshkruan një marrëveshje dypalësh me këto njësi mbi delegimin e këtyre përgjegjësisive dhe kompetencave.

Në pikën 11 të projektvendimit përcaktohet se shpenzimet për prodhimin dhe administrimin e kartës së studentit do të përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në rast se prodhimi dhe administrimi i kartës së studentit do të delegohet te njësitë e vetëqeverisjes vendore, atëherë, shpenzimet do të përballohen nga buxheti i këtyre njësisive.

Shpenzimet për prodhimin dhe administrimin e kartës së studentit do të përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në rast se prodhimi dhe administrimi i kartës së studentit do të delegohet te njësitë e vetëqeverisjes vendore, atëherë, shpenzimet do të përballohen nga buxheti i këtyre njësisive

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara, përmes përdorimit të kartës së studentit”

Në pikën 12 të projektvendimit përcaktohet, se Qendra e Shërbimeve Arsimore, konfirmon për çdo vit akademik studentët e regjistruar në vitin përkatës akademik për çdo institucion të arsimit të lartë, pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, në rastin e delegimit të prodhimit dhe administrimit të Kartës së Studentit.

Qendra e Shërbimeve Arsimore, është institucion i posaçëm për organizimin, monitorimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore për sigurimin e cilësisë. Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit. Qendra e Shërbimeve Arsimore, krijon, arkivon, përditëson dhe administron bazën elektronike të të dhënave të nxënësve, në Republikën e Shqipërisë.

Qendra e Shërbimeve Arsimore, konfirmon për çdo vit akademik studentët e regjistruar në vitin përkatës akademik për çdo institucion të arsimit të lartë, pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, në rastin e delegimit të prodhimit dhe administrimit të Kartës së Studentit.

VII. MINISTRITË, INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti shoqërohet me disa efekte financiare si efektet për prodhimin dhe lëshimin e kartës.

PROPOZUESI

MINISTRI I ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

BESA SHAHINI

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara, përmes përdorimit të kartës së studentit”